



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

Nr. 2718/3 Prot.,

Tiranë, më 8.6. 2023

**SHPALLJE**  
**TË LISTËS SË KANDIDATËVE TË KUALIFIKUAR**  
**DRAKU TIRANË**

Në mbështetje të ligjit nr.7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në RSH”, i ndryshuar, neni 19, pika 1 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në RSH”, të ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, i ndryshuar, të Rregullores së Brendshme për organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, të miratuar me Urdhrin nr.297 datë 23.6.2022. të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ligjit nr. Nr.9863, datë 28.1.2008 “Për Ushqimin”, i ndryshuar, në VKM-në nr. 708 datë 9.9.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, Ligjit nr. 10433 datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Urdhrit të Kryeministrit nr. 128, datë 26.10.2020 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, Urdhrin Nr. 659 Prot., datë 2.2.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së për miratimin e Manualit të Rekrutimit ,

**Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, në përfundim të procesit të verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacioneve të dorëzuara nga kandidatët për 2 (dy) pozicione të lira pune të shpallura në Drejtorinë Rajonale të AKU-së, Qarku Tiranë,**

- 1 (një) pozicion i lirë pune **“Inspektor”** në Sektorin e Kontrollit të Mbrojtjes së Bimëve dhe Inputeve Bujqësore;
- 1 (një) pozicion i lirë pune **“Specialist (Arkiv-Protokolli)”** në Sektorin e Financës dhe Sherbimeve të Brendshme;

## N J O F T O N:

1. Lista e kandidatëve të kualifikuar për të vazhduar fazën e dytë të konkurrimit është si vijon:

- **Znj. Iva Bega**
- **Znj. Nertila Stafa**

2. Intervista do të zhvillohet **më datë 12.6.2023, ora 10:00**, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU, adresa Rruga “Bardhyl”, Ndërtesa Nr. 93, Njësia Administrative Nr. 3, Tiranë.

3. Kandidatët do të intervistohet në lidhje me:

- Njohuri të përgjithshme për Kodin e Punës për të drejtat e detyrimet e punëdhënësit e punëmarrësit;
- Njohuri mbi VKM-në nr. 708, datë 9.9.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”;
- Njohuri mbi Ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (për pozicionin **“Inspektor”** në Sektorin e Kontrollit Mbrojtjes së Bimëve dhe Inputeve Bujqësore);
- Njohuri mbi Ligjin Nr. 105/2016, datë 27.10.2016 “Për Mbrojtjen e Bimëve”, i ndryshuar (për pozicionin **“Inspektor”** në Sektorin e Kontrollit Mbrojtjes së Bimëve dhe Inputeve Bujqësore);
- Njohuri mbi Ligjin Nr. 10416, datë 07.04.2011 “Për Materialin Mbjellës dhe Shumëzues Bimor”, i ndryshuar (për pozicionin **“Inspektor”** në Sektorin e Kontrollit Mbrojtjes së Bimëve dhe Inputeve Bujqësore);
- Njohuri mbi Ligjin Nr.17/2020 datë,17.02.2020 “Për Produktet Plehëruese” (për pozicionin **“Inspektor”** në Sektorin e Kontrollit Mbrojtjes së Bimëve dhe Inputeve Bujqësore);
- Ligji Nr. 9154, date 6.11.2003 “Për Arkivat” (për pozicionin **“Specialist (Arkiv-Protokoll)”** në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme);
- Njohuri për sa i përket “Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë” (për pozicionin **“Specialist (Arkiv-Protokoll)”** në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme).

4. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatit është 100, të cilat ndahen përkatësisht:

- 50 pikë për jetëshkrimin/eksperiencën/pastërtinë e figurës
- 50 pikë për intervistën me gojë.

5. Shpallja e fituesve bëhet në faqen zyrtare brenda 5 ditëve pune nga përfundimi i intervistës.
6. Çdo kandidat ka të drejtën për ankimim jo më vonë se 48 orë nga shpallja e listës së fituesve.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

